



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 108, Datë 10.07.2017

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “SKATINA HEC”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SKATINA” ME FUQI TË
INSTALUAR 2677 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”a” të Ligjit nr.43/2015, ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 5, gërma ” a”; 13 dhe 21 të ”Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ”Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e Shoqërisë “SKATINA HEC” sh.p.k., si dhe informacionin shtesëtëpërgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec “SKATINA”,

Konstatohet se :

- ERE me Vendimin me nr. 32, datë 09.03.2016, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “SKATINA HEC” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Skatina” me fuqi të instaluar 2677 kw.
- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s datë 19.04.2017, është evidentuar dokumenti i pa plotësuar nga kjo shoqëri “Miratimi i pikës së lidhjes”.
- Shoqëria “SKATINA HEC” sh.p.k., me shkresën nr.110 Prot., datë 07.06.2017, paraqitur dokumentacionin plotësues si më poshtë:
 - Miratim pikë lidhje “SKATINA HEC” me nr. 1236/3 Prot., datë 24.05.2017.
 - Marrëveshja e Lidhjes së Re me nr. 1236/2 Prot., datë 24.05.2017.
- Aplikimi i shoqërisë “SKATINA HEC”sh.p.k., plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ” a”, ” b” dhe ” c”) është plotësuarnëmënyrëkorrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ” a”, ” b”, ” c”, ” d”, ” e”, ” f” dhe ” g”) është plotësuarnëmënyrëkorrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat ” a”, ” b”, ” c” dhe ” d”) është plotësuarnëmënyrëkorrekte;
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuarnëmënyrëkorrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SKATINA HEC” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Skatinë”, me fuqi të instaluar 2677 KW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI